

VENDIM
Nr.48, datë 1.9. 2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE TË HAPURA TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S”

Mbështetur në nenin 3 pika 4 dhe nenin 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimin nr.26, datë 13.5.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me ndryshimet përkatëse, “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE”, neni 8 germa A, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.9.2005, mbasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun, për rregulloren për procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Miratuar me vendim nr.48, datë 1.9.2005 të Bordit të Komisionereve të ERE-s

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE TË HAPURA TË BORDIT TË KOMISIONERËVE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në përputhje me nenin 8 germa A “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë transparencën e mbledhjes së Bordit të Komisionerëve dhe t’u krijojë akses palëve të interesuara për të marrë pjesë në këto mbledhje.

Neni 3
Objekti

Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të përgjithshme për zhvillimin e mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

KAPITULLI II PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE

Neni 4 **Njoftimi i mbledhjes**

ERE do të sigurojë njoftimin për publikun 48 orë para zhvillimit të një mbledhjeje të hapur të programuar të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. Njoftimi do të përmbajë: datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, si dhe rendin e ditës. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes vendoset në një vend të posaçëm në hyrje të ERE-s, si dhe publikohet në faqen zyrtare të ERE-s në internet.

Neni 5 **Zhvillimi i mbledhjes**

1. Para fillimit të çdo mbledhje vendimmarrëse të Bordit të Komisionerëve, sekretarja do të regjistrojë në një regjistër të posaçëm emrat e personave që kërkojnë të marrin pjesë në mbledhje.
2. Në momentin e hapjes së mbledhjes, sekretarja u bën të njohur pjesëmarrësve, nëpërmjet leximit, procedurat e zhvillimit të mbledhjes, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.
3. Në një mbledhje të hapur të Bordit të Komisionerëve të ERE-s kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e Bordit të Komisionerëve dhe përfaqësuesit e ERE-s, si dhe me leje të Bordit edhe persona të tjerë që kanë lidhje me përgatitjen dhe administrimin e këtyre çështjeve.
4. Sekretarja do të regjistrojë në procesverbal të gjitha çështjet që u diskutuan nga Bordi dhe votimin për secilën çështje.
5. Me kërkesë të palëve të interesuara, sekretarja e Bordit do t'i lejojë ato të njihen me procesverbalin e mbledhjes, si dhe me vendimin e Bordit.

Neni 6 **Të drejta e detyrime të publikut**

1. Gjatë zhvillimit të një mbledhjeje vendimmarrëse të Bordit të Komisionerëve, çdo person që do të marrë pjesë ka të drejtë të dëgjojë e të mbajë shënime, por nuk ka të drejtë të flasë apo të bëjë pyetje, me përjashtim të rasteve kur Bordi e deklaron një gjë të tillë. Ndalohet gjithashtu ndërprerja e fjalës së diskutantit, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit.
2. Nëse ndonjë nga personat pjesëmarrës në mbledhjen e Bordit të Komisionerëve do të konsiderohet se prish qetësinë dhe mbarëvajtjen e mbledhjes, me urdhër të kryetarit do të procedohet me largimin e tij.
3. Kur cenohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes, kryetari vendos për ndërprerjen e mbledhjes, për jo më shumë se 30 minuta, ose shtyrjen e saj pas marrjes së miratimit nga Bordi.

KAPITULLI III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 7 **Amendamente të rregullores**

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve.

Neni 8 **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.